02 Nr. 1103
22.10.2026

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDİYESİ

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PREDSEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr.016-126211, të dt. 06.11.2014 me ndryshime dhe plotësime në Statut 01.nr.016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës në cilësinë e organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës nxjerr:

V E N D I M

1. Me këtë vendim, nëpunësi civil Muhamet Kqiku, i caktuar në detyra punuese: Zyrtar Ligjor në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, **Autorizohet** të ju ofrojë mbështetje në përgatitjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit juridik në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari, nga data 22.10.2026 deri në një vendim tjetër.

2. Nëpunësi civil, i autorizuari, do t'i ushtroj të drejtat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Juridik në pajtim me dispozitat ligjore.

3. Me ndryshimin e këtij vendimi, i autorizuari kthehet në detyrat e mëparme punuese para autorizimit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

5. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet:
- Muhamet Kqiku
- DGJKP, DBP
- NJBNJ
- Arkivit

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni